

Njoftim i përqendrimit me të cilin Grupi Modirum OU, Estoni do të fitojë kontrollin mbi ITgma SHPK Shkup Maqedonia e Veriut

(lënda nr. 08-85/2024)

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 16.05.2024, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilën Grupi Modirum OU, me seli në Qarkun Harju, Talin, rrethi Keklina, distrikti Parnu 139e/2, 11317, Estoni, do të marrë kontrollin mbi Shoqërinë për programim kompjuterik dhe shërbime këshilluese ITgma SHPK Shkup, me një adresë në selinë e rr. Ankarska nr. 29a, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, nëpërmjet blerjes së një pjese.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

Grupi Modirum OU kryen biznes dhe aktivitete të tjera këshilluese për menaxhimin e shoqërive brenda Modirum Group, kryen konkretisht veprimtaritë e zyrës kryesore, aktivitete këshillimore-menaxhuese dhe aktivitete të tjera afariste dhe këshillimore-menaxheriale. Shoqëri të tjera nga grupi gjithashtu kryejnë punë këshilluese kompjuterike.

Grupi Modirum është i pranishëm në tregun e Maqedonisë së Veriut përmes Shoqërive të mëposhtme:

- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime VEB FAKTORI SHPK Shkup, me seli në Bul. Brigada e 3-të maqedonase nr. 56, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, Shoqëria që zhvillon softuer dhe kryen shërbime të tjera IT; dhe
- Shoqëria për marketing dhe shërbime LAJTHAUS UAN SHPK Shkup, me seli në Blv. Brigada e 3-të maqedonase nr. 56, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, Shoqëria që kryen aktivitete marketingu.

Shoqëria për programim kompjuterik dhe shërbime konsulente ITgma SHPK Shkup punon në industrinë e TI-së, konkretisht në fushën e kryerjes së aktiviteteve kompjuterike-konsulente, programimit kompjuterik dhe shërbimeve tjera të ngjashme të TI-së. Gjithashtu ofron softuer dhe shërbime të TI-së në disa industri, si: telekomunikacion, banka dhe financa, softuer dhe shërbime TI, sektorë publikë dhe qeveritarë.

Shoqëria për programim kompjuterik dhe shërbime konsulente ITgma SHPK Shkup ka themeluar edhe tri shoqëri të tjera në pronësi 100%, dhe atë:

- Shoqëria për programim kompjuterik dhe shërbime konsulente ITgma Sourcing SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Ankarska nr. 29A, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut;
- ITgma SHPK BEOGRAD-NOVI BEOGRAD, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe me seli në Republikën e Serbisë; dhe
- ITgma EMEA FZ LL, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe me seli në Emiratet e Bashkuara Arabe.

Parashtruesi i njoftimit konsideron se si treg relevant për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet tregu i softuerit dhe shërbimeve të TI-së, ndërsa si treg relevant gjeografik mund të përcaktohet territori i Maqedonisë së Veriut

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

20.05. 2024

Shkup